




FRANÇESKANËT I PËRGJIGJEN PANDEMISË ME MINISTRAT KRIJUES

Takimi me Krishtin e Ringjallur, që na liron prej frikave që na bëjnë të rrimë të palëvizshëm, na nxit të dalim prej vetvetes, prej sigurive dhe rehative tona, prej logjikës së «është bërë gjithmonë kështu», për të rimarrë rrugën e Ungjillit, që është gjithmonë risi, sepse është «Fjalë e jetës së pasosur» (Gjn 6, 68). Takimi me të Ringjallurin bëhet mision dhe shpallje e jetës së re, sepse «për ata që e kanë takuar, që jetojnë në miqësinë e tij dhe që identifikohen me mesazhin e tij, është e pashmangshme që të flasin për Të dhe t'ua çojnë të tjerëve propozimin e tij për jetë të re: i mjeri unë nëse nuk e shpall Ungjillin!» (Querida Amazonia 62).

Mënyrat krijuese me të cilat françeskanët e të gjithë botës vazhdojnë t'u shërbejnë personave, në mes të pandemisë globale, i kanë kthyer fjalët e **Letrës së Pashkëve 2020** të Ministrat gjeneral në një realitet praktik.

Kuvende, famulli dhe shenjtërore të panumërta i përdorin mediat sociale për të transmetuar online meshë të shenjta, reflektime, adhurime eukaristike, rruzare dhe lutje të ndryshme.

Në Varrin e Shenjtë të Jerusalemit, në zemrën e Tokës së Shenjtë, pavarësisht prej mungesës totale të shtegtarëve, fretërit dhe bashkësitë e tjera të krishtera vazhdojnë të mbajnë *Status Quo*-në (marrëveshje e hershme që rregullon modalitetet me të cilat grupet e ndryshme të krishtera hyjnë në vendet më të shenjta). Liturgjitë janë kremtuar gjithnjë në varrin e Shpëtimtarit tonë, në Kalvar dhe në të gjitha vendet e shenjta brenda Varrit të Shenjtë. Vizito sitin **cmc-terrasanta.org** për të ndjekur të gjitha lajmet e botuara në gjashtë gjuhë.

Në Spanjë, Provinca e Zojës së Papërlyer, referon se në një prej kuvendeve të tyre ka pasur një publik të papritur për meshët e shenjta online: "Mesha në kishën françeskane të Sabadellit është bërë virale, me më shumë se 20.000 shikime. Ndjekësit e meshës së përditshme në Facebook mund të bëjnë komente, të shikojnë versionin e regjistruar apo të dërgojnë njete [...]. Në këto kohë, në të cilat izolimi mund të çojë në trishtim e në shkurajim, këta tre fretër [...] shndërrojnë një gjysmë ore në një oaz paqeje dhe në një

mjet efikas humori të mirë, shprese e ngushëllimi. Një sukses me të vërtetë i papritur të konstatohet se, gati çdo ditë, persona me prejardhje nga pesë kontinentet mund të sintonizohen në shtatë të mbrëmjes." Lista e transmetimeve të ndryshme online në gjuhën spanjolle është e disponueshme në **www.ofminmaculada.org**.


Fretërit edhe kanë bashkëndarë talentet e tyre muzikore. Nga Asizi, talenti i fra Aleksandrit është **transmetuar në stremiting në mediat sociale** kur tenori françeskan ka kënduar vetëm në Bazilikën shumë të madhe e të zbrazët të Shën Marisë së Engjëjve. Në Brazil mund të shihen **fretërit e pesë kuvendeve** në veri-lindje të Brazilit duke vallëzuar sipas ritmit karakteristik brazilian të njohur si *frevo*. **Catholic News Service/Crux** ka publikuar lajmin e videos së tyre të bërë virale me refrenin e tyre tërheqës: "Fique em Casa" (Qëndro në shtëpi). Tekstet i nxisin personat të gëzojnë lidhjen me familjet e tyre dhe, edhe fretërit, porosisin larjen e saktë të duarve. Thonë: "Dëgjo radion, shiko TV; ka shumë mundësi për të qeshur e për t'u lutur".

Provinca Toskane (Itali) ka ideuar një nismë që përballon çështjet psikologjike e shpirtërore duke ofruar një "Shërbim dëgjimi" (Shërbimi #TëDëgjoj). Shumë fretër dhe një psikoterapeut janë të gatshëm të flasin në telefon apo në Skype me personat që kanë nevojë për mbështetje. Shërbimi (në italisht) është falas. Vizito **ofmtoscana.org** për detajet.

Një seri podcast-esh, që përfshijnë argumente përshpirtërie, psikologjie, françeskanizmi dhe mirëqenieje shoqërore, në portugalisht, është publikuar nga Provinca e Zojës së Papërlyer në Brazil. Shpresa është që t'u japin dëgjuesve informacionet dhe formimin për të përballuar temën e pandemisë sipas pikëpamjeve të ndryshme dhe fushave të kompetencës. Podcast-et gjenden në **franciscanos.org.br**.

Bota, Kisha dhe vëllazëritë tona kanë nevojë të dëgjojnë mesazhin e Hyjit: jemi ne bartësit e këtij lajmi të mirë, le t'ua japim të gjithëve me bujari lajmin e mirë që buron prej Pashkëve!

SHËNUES LIBRI FRANÇESKAN



BARTOLOMEU I PIZËS, *The Conformity - Francis of Assisi: Early Documents (Përngjasimi – Françesku i Asizit: Dokumentet e para)*, New City Press, Hyde Park 2020.

Njëzet vjet më parë ka dalë “*Françesku i Asizit: Dokumentet e para*”, një përmbledhje në tre vëllime të shkrimeve të Françeskut dhe të burimeve hagiografike mesjetare në lidhje me të deri në gjysmën e shekullit XIV. Tani, kjo seri do të vazhdojë me botimin e një veprë shumë të madhe, “*Il Libro della Conformità della Vita di San Francesco alla Vita di Nostro Signore Gesù Cristo*” (“*Libri i Përngjasimit të Jetës së Shën Françeskut me Jetën e Zotit Tonë Jezu Krishtit*”), shkruar nga fra Bartolomeu i Pizës mes viteve 1385-1390.

Il Libro della Conformità – Libri i Përngjasimit (shpesh i quajtur Le Conformità - Përngjasimet) paraqet pikën më të lartë të lartësimit mesjetar të figurës së Shën Françeskut. Përmban një dokumentacion pothuajse të plotë të shkrimeve të shenjtit dhe një rezervë të gjerë materiali të ardhur nga të gjitha legjendat hagiografike të shenjtit të njohura nga shek. XIII deri në shek. XIV. Gjithashtu, është e pranishme një listë e gjatë e vendeve në të cilat fretërit françeskanë, motrat klarise dhe terciarët françeskanë kanë jetuar dhe shërbyer, me hollësi personale në lidhje me shumë personazhe françeskane, si të njohur ashtu edhe të panjohur.

Autori, Bartolomeu i Pizës, e ka ndarë veprën e vet të madhe në 3 “Libra”, siç i quan ai vetë. Pjesa e parë ka lidhje me Mishërimin, Lindjen dhe vitet e para të jetës së Jezusit, me përngjasime korresponduese në vitet e para të jetës së Françeskut. Pjesa e dytë ka lidhje me vitet e shërbesës publike të Jezusit, predikimin dhe shërimet e tij, thirrjen e nxënësve, udhëtimet e tij nga një vend në tjetrin, me ngjarje të ngjashme në jetën e Françeskut. Pjesa e tretë ka lidhje me Mundimet, Vdekjen, Ringjalljen dhe të Ngjiturit në qiell / Lavdërimin e Krishtit, dhe ngjarjet e ditëve të fundit të Françeskut, sëmundjet dhe vuajtjet e tij, ngulitjen e stigmave, vdekjen e tij, kanonizimin dhe mrekullitë që i janë atribuar si ndërmjetësues qiellor.

Për gjashtë shekuj ky tekst, kaq jetësor për bashkësitë e krishtera që ishin arritur nga jeta e shën Françeskut, nuk është botuar kurrë në një gjuhë moderne. Ky përkthim pa precedentë ia sjell *Librin e Ngjashmërisë* lexuesit të sotëm.



Francisco Martínez Fresneda, ofm
**FRANCISCO DE ASÍS
Y
LA SALVACIÓN**


**FRANCISCO MARTÍNEZ
FRESNEDA OFM, *Francisco de Asís y la salvación (Françesku i Asizit dhe shëlbimi)*, Ediciones Franciscanas Arantzazu, Oñati 2020, fq. 256.**

Në këtë libër autori na flet për shëlbimin e Hyjit nëpërmjet përvojës së shëlbimit të Françeskut të Asizit.

Vepra është e ndarë në tre kapituj. Kapitulli i parë trajton marrëdhëniet mes Hyjit e njeriut dhe të njerëzve mes tyre sipas Mishërimit të Fjalës në jetën e Jezusit që, me fuqinë e Shpirtit, ndriçon, në radhë të parë, një botë të re: krijimin.

Kapitulli i dytë trajton mundësinë e një historie të re që rrjedh prej lindjes së ndjenjës së re për njerëzimin. Dhe kapitulli i tretë trajton krijimin e një njeriu të ri falë ngjashmërisë me Krishtin që e favorizon Shpirti, duke i dhënë zanafillë identitetit bijësor hyjnor.

Dy kapitujt e parë – shëlbimi i kozmosit dhe i historisë njerëzore – ndjekin skemën e Këngës së Krijesave, që riprodhon strukturën e lutjes Ati ynë: Zoti bën të mundur të ushqyerit, bashkëjetesën njerëzore dhe kapërcimin e tundimit e të vdekjes, si përfaqësuesja më e lartë e së keqes.



GIUSEPPE CAFFULLI (nën kujdesin e), *Santi per attrazione - I Protomartiri francescani tra Antonio di Padova e Chiara d'Assisi (Shenjtër për tërheqje – Protomartirët françeskanë mes Antonit të Padovës dhe Kjarës së Asizit)* Edizioni Terra Santa, Milano 2020, fq. 96.

Tetëqind vjet pas martirizimit, kontributet e kësaj përmbledhjeje hedhin një dritë

të re mbi aspekte historiografike dhe teologjike pak të shqyrtuara, duke rivendosur në plan të parë vlerën e shembullit të këtyre figurave të largëta.

Quheshin Berard, Oton, Pjetër, Akurs dhe Adiut. Qenë martirët e parë të Urdhrit françeskan, të vvarë në Marok më 16 janar 1220. Qenë ndër të parët që përqaftuan jetën minoritike dhe ndër misionarët e parë të dërguar nga Françesku i Asizit në tokat e saraçenëve. Në Sivilje, në Spanjë, filluan të predikonin fenë e Krishtit në xhami, por shpejt i keqtrajtuat, i futën në burg dhe i çuan para sulltanit Almohad Muhammad al-Nasir, i quajtur Miramolin, dhe pastaj i transferuan në Marok me urdhrin që të mos predikonin më në emër të Krishtit.

Burimet françeskane tregojnë se kur mori lajmin se u ishte prerë kryet, Françesku i Asizit thirri: «Tani mund të them me siguri se kam pesë fretër minorë».